V E N D I M
Nr.135, datë 13.4.2002

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE ", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

a)Në lidhjen I "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", në shkronjën B1 shtohet emërtimi "Kryetari i Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike".

b)Shtohet lidhja II-28 me emërtimin "Nivelet e pagës për punonjësit e Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike", e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Efektet financiare, që rrjedhin ngazbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lidhja II -28

Nivelet e pagës për punonjësit e agjencisë së inventarizimit dhe transferimit të pronave publike

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi	
Kryetari i Agjencisë…….		B1	
Nr.	Emërtimi i punonjësit	Niveli i Pagës	
		Klasa	Shtesa për funksion (grupi)
1.Përgjegjës sektori……..		X	6
2.Specialist në qendër dhe qark ……..		IX	

Shënim: Për punonjësit e tjerë zbatohen pagat sipas Lihjes II-5 "Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore", të këtij vendimi